

**VENDIM**  
**Nr. 205, datë 25.3.2021**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E  
RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NË BASHKITË DURRËS DHE  
KAVAJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nëndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 222 267 242 (dyqind e njëzet e dy milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e dyzet e dy) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, sipas aktekspertizave të thelluara, në bashkitë Durrës dhe Kavajë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi, në masën 65 749 664 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e shtatëqind e dyzet e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë, për rindërtimin e 22 (njëzet e dy) njësive individuale të banimit për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para;

b) Bashkisë Kavajë i transferohet fondi në masën 156 517 578 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë milionë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë për rindërtimin e 57 (pesëdhjetë e shtatë) njësive individuale të banimit për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe u transferohet bashkive Durrës dhe Kavajë në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Durrës e Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**